

VENDIM
Nr.269, datë 10.5.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.503, DATË 30.6.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
KONFISKUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.503, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, më poshtë “Agjencia”, është pjesë përbërëse e aparatit të Ministrisë së Financave.”.

b) Paragrafi i dytë i pikës 4, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha